



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 154 dt.10.10.1996

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.10.10.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Propozim për kalim në fond banese dhe pajisje me autorizim definitiv” në zbatim të ligjit Nr.7592, dt.10.05.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.530, dt.17.10.1994, të Vendimit Këshillit Ministrave Nr.49, dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehë” si dhe vendimit të K.M.Nr.379, dt.26.06.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e Këshillit Nr.81, dt.28.02.1994 për kthimin në fond banese të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë dhe Ministrisë Rendit”, pika.3,

VENDOSI

1. Të miratojë kalimin në fond banese objektin godina e ish laboratorit biokimik pranë Q.S.U.Tiranë dhe të pajisi me autorizim definitiv familjet e pastreha dhe të persekutuara politike që banojnë aty.

- Zenel Lleshi	për 1 dhomë
- Sadik Lleshi	për 1 dhomë
- Ahmet Lleshi	për 2=1
- Halit Lleshi	për 2=1
- Liman Kaca	për 2=1
- Ibrahim Lleshi	për 1=1 + aneks

- Murat Lleshi për 1=1

2. Të kalojë në fond banese definitiv ish zyra fronti e lagjes Nr.30 në Rr."M.Gjolllesha" Pall.13 dhe të pajisi me autorizim definitiv qytetarin Vladimir Kasemi për 1=1.
3. Të kalojë në fond banese objektin ish Estrada e Ushtarit që ndodhet pranë Gardës së Republikës.
4. Të kalojë në fond banese objektin ish depo Nr.1 dhe Nr.2 tek Rrapi i Trishit në Institutin Topografik të Ushtrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Seksioni i Strehimit të Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA